



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

---

Numri i lëndës: 2019:131728

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06789481

**P.nr.186/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Selman Salih, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurës Hava Bleta nga fsh.Gllanicë K.Lipjan të cilën e ka akuzuar Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP.II.nr.1099/2019 të datës 14.03.2019, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u kujdesur lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale, jashtë seancës, me datën 31.01.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. H U D H E T** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë me nr. PP.II.nr.1099/2019 të datës 14.03.2019 dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurës:

**Hava Bleta**, nga i ati Sefa, e lindur më dt. 05.10.2018 në fsh.Gllanicë K.Lipjan, me nr. personal 1010665201, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, pasi që për të pandehurën ka arritur **parashkrimi absolut i ndjekjes penale**.

**II.** Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.1099/2019 të datës 14.03.2019 ndaj të pandehurës Hava Bleta nga fsh.Gllanicë K.Lipjan për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut i ndjekës penale andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata ka ndermarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale mirëpo përkundër përpjekjeve i njejtë ka qenë i paarritshëm për organet e ndjekjes te Republikës së Kosovës.

Për veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së është paraparë që kryesi të dënohet me burgim deri në tri (3) vite.

Me nenin 106 par.1 pika 1.5 të KPRK-së parashihet se parashkrimi shkaktohet në afat prej tri (3) vitesh nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë.

Meqenëse vepra penale nga ana e të pandehurës është kryer me dt.05.10.2018, gjykata vlerësoi se është arritur parashkrimi absolut dhe ndalesa absolute e ndjekjes penale kundër të pandehurës është arritur me dt.05.10.2024.

Në bazë të nenit 107 par.8 të KPRK, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, respektivisht ndalesa absolute mbi ndjekjen penale, e që në rastin konkret parashkrimi për veprën penale të lartcekur ka arritur, ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Nga këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN,**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.186/19 i dt.31.01.2025**

**Gjyqtari**  
**Selman Salih**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 (tre)dite nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.